



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:118178
Datë: 27.04.2021
Numri i dokumentit: 01738017

C.nr. 240/18.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Migjen Kastrati, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit, S. L., nga fshati, Komuna e, të cilën e përfaqëson F. A. avokat nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria e Arsimit në Istog, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunale, A. A., baza juridike: për kompensimin e pagave përcjellëse në pension dhe shpërblim jubilar, vlera e kontestit: 2,571.60 euro, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 20.04.2021, dhe përpiluar me dt. 27.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit, S. L. nga fshati, Komuna e

II. DETYROHET e paditura Komuna e Istogut – Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, që paditësit, S. L., nga fshati, Komuna e, në emër të kompensimit të shpërblimit për 3 (tri) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, në shumë prej: 1,356.60 euro, dhe në emër 3(tri) pagave të shpërblimit jubilar, sipas listës së pagave, në shumë prej: 1,215.00 euro, dhe atë në shumë të përgjithshme prej: **2,571,60 euro**, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e marrjes së këtij aktgjykimi me datën: 20.04.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Istogut – Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, që paditëses t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej, 508 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi S. L., përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi, me datën: 26.07.2018, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria e Arsimit në Istog, me padinë të precizuar, gjatë seancës se shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbete në tërësi pranë padisë përkatësisht pranë precizimit të kërkesëpadisë të cekura si në referatin e padisë provave të bashkangjitura, ku është argumentuar qartë se kërkesëpadisë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, se paditësi sipas njoftimit të lëshuar nga DKA, i njëjti është pensionuar, 01.08.2016, në pozitën e mësimdhënësit në kuadër të SHFMU “.....” në, ndërsa sa i përket përgjigjes në padi këtu e paditura është pa argumentuar për faktin se baza juridike është e mbështetur në bazë të marrëveshjes kolektive ku e rregullimin jubilar dhe pagën përcjellëse, po ashtu sa i përket lartësinë është argumentuar edhe në bazë të provës të cilën e ka bashkangjitur vet e paditura sa i përket listës së pagës, ku paga baza është 405 Euro ndërsa paga përcjellëse është argumentuar në bazë të llogarisë se gjendjes bankare të

paditësit, e cila është 452.20 Euro. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe me tutje mbesim pranë padisë përkatësisht pranë precizimit të kërkesëpadisë se dt. 13.01.2021 ku pas administrimit të provave është argumentuar qartë kërkesëpadija e paditëset si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, ku një gjë e tillë është argumentuar edhe në bazë të Marrëveshjes se Përgjithshëm të Kosovës e cila ka hyre në fuqi me dt. 01.01.2015, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 52 e 53 të kësaj marrëveshje, meqenëse se paditësi ka dal në pension me dt. 01.08.2016 dhe në bazë të kësaj marrëveshje të njëjtin i takojnë 3 (tri) paga jubilarë sipas pagës bazë e cila është 405 Euro dhe 3(tri) paga përcjellëse në pension e cila është 452.20 bruto, të cilat janë të argumentuara edhe me provat materiale po thuajse të gjitha provat e lëshuar nga këtu e paditura, andaj i propozojmë gjykatës që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke i specifikuar dhe atë : 104 euro, për përpilimin e padisë, 104 për parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë, 30 euro për taksen për padi, për dy seancë gjyqësore 270 euro, për secilën nga 135 euro, e në shumën e përgjithshme prej: 508 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokateve të Kosovës.

Përfaqësuesi i të paditurës Avokati Publik Komunal, në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes se dhëne me shkrim dorëzuar në këtë gjykatë me dt. 14.11.2019, duke shtuar me tutje se kam pranuar parashtresën për precizim, kam pranuar edhe lajmërimin për pensionim për paditësin, listat e pagës janë dorëzuar nga e paditura të siguruar sipas detyrës zyrtare e cila i është bashkangjitur përgjigjes në padi, sa i përket bazës juridike Kontrata Kolektive e Arsimit para Universitar nuk ka qenë e regjistruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenës sociale siç kërkohet në udhëzimin administrativ me nr. 12/2011, me nenin 6 të këtij udhëzimi shqyrtohet ligjshmëria e këtyre marrëveshjeve e në qoftë se nuk janë në harmoni me ligjet, parashtresë i kërkesës për regjistrimin e kontratës njoftohet për korrigjim dhe plotësim të kontratës. Nuk kam të dhëna sa një kontratë e tillë është regjistruar, për këtë konsiderojmë se e njëjtat nuk mund të zbatohet në bazë të nenit 10 të kësaj udhëzimi administrativ. Është obligim i nënshkruesve që çdo ndryshim ta lajmërojnë në departamentin Ligjor në Ministrinë e Punës, kusht ky për zbatim të një kontrate apo marrëveshje të tillë, Kontrata e tillë ka qenë në kundërshtim me nenin 4 par.1 të Ligjit të Punës, ngase dispozitat e kontratës kolektive dhe aktit të brendshëm të punëdhënësit e parasheh se duhet të jenë të harmonizuara dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me ligjin e punës neni 90 par. 5 është paraparë që Kontrata Kolektive për të gjitha ata punëdhënës dhe punëmarrës vlen për obligimet që i marrin përsipër, duke lenë në diskrecion zbatimin ose mos zbatimin e kësaj Komunitat nuk kanë nënshkruar kurrfarë Kontrate, Marrëveshje për veç kontratës së punës me të punësuarin të cilit i kanë pushuar të gjitha të drejtuar nga marrëdhënia e punës me rastin e pensionimit, Ligji për Buxhetin e Kosovës me nenin 2 në mënyre shprehimore i obligon komunitat që buxhetin ta shpenzojnë në harmoni me Ligjin për buxhet e në pajtim me vendimet komunale për aprovimin e buxhetit për vitin përkatës kur është paraqit padia, për vitin 2018, në mungesë të bazës juridike dhe njoftimit nga Ministria përkatëse e Arsimit dhe për kundër zotimit të tyre se do të angazhohen në sigurimin e buxhetit të nevojshëm të komunave për këtë kategori, një obligim i tillë nuk është përmbushur nga Ministrit respektivë as nga Sindikatat. Për këtë edhe kjo kategori e të punësuarve ka ngelë si barrë e buxhetit të Komunitat pa fajë dhe përgjegjësinë e saj. Për këtë edhe është kontestuese periudha për të cilën paditësi e kërkon kompensimin. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se qëndrojmë në tërësi pranë përgjigjes në padi dorëzuar në këtë gjykatë me dt. 14.11.2019, theksimeve të than në këtë seancë me propozim që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar - specifikuar, ndërsa shpenzimet e kërkuar nga i autorizuari i paditëses i ka kundërshtuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat : Lajmërimi për përfundimin e shërbimit të pensionimit, Drejtoria e

Arsimit dhe Kulturës me Nr.05.nr.1167/16 i dt. 01.08.2016, Vërtetimi me nr. 2585/2016 i dt. 01.12.2016, të lëshuar nga SHFMU “.....”, në fshatin, Komuna e, Kontrata e Punës me nr. 05 nr. 1179/13 i dt. 11.10.2012, Qarkullimi për llogari bankare të lëshuar nga, prej dt. 01.05.2016-31.07.2016, e lëshuar në emër të S. L., fotokopje e letër njoftimit për S. L., lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, 01.06.2016 e deri 30.06.2016, vendimi i lëshuar nga Departamenti i Pensioneve i datës 23.08.2016, kërkesa e datës 08.05.2018, e paditësit njoftimi i DKA në Istogu, me numër 05.Nr.197/18 i dt.10.05.2018, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ‘.....’, nr. 660 i dt. 02.12.2016, si dhe deklaratimet e të autorizuarave të ndërgjyqësve.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se **kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.**

Nga leximi i Lajmërimit për Përfundimin e Shërbimit Pensionimit me numër 05 Nr. 1167/16 i datës: 01.08.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës në Istog, është vërtetuar fakti se paditësit i është ndërprerë përfundimisht marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit me datën: 01.08.2016.

Nga leximi i Vërtetimit me Nr. 2585/2016 i datës: 01.12.2016, të lëshuar nga SHFMU “.....” në, Komuna e Istogut, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka punuar si Mësimdhënëse e ciklit fillor, nga data: 01.10.1980 e deri me datën e pensionimit: 01.08.2016.

Nga leximi i vërtetimit me nr. 660 i dt. 02.12.2016, të lëshuar nga SFMU “.....”, në, gjykata ka vërtetua se paditësi ka punuar si mësues Klasik nga data 01.11.1976 e deri me dt. 31.09.1980, nga gjithsejtë stazh punë në Shkollë: 40 vite.

Nga leximi i Kontratës e Punës, 05 Nr. 1179/13 i datës 11.10.2012, të lidhur në mesë Punëdhënësit - Drejtoria Komunale e Arsimit, dhe pune kryesit: S. L., gjykata ka vërtetuar se paditësi ka punuar si mësimdhënësi i mësimin klasor në Shkollën Filllore “.....”, në Fshatin, Komuna e, deri në datën e përfundimit të shërbimit: 01.08.2016, arsye e përfundimit të shërbimit pensionimi.

Nga leximi i pasqyrës së llogarisë bankare në ProCreditBank e datës, 30.11.2016, për këtu paditësin S. L., gjykata ka konstatuar që të ardhurat për 3(tre) Muajt e fundit për paditësin kanë qenë në shumën prej: 452.20 €, për një pagë mujore.

Nga kërkesa e paditësit drejtuar Drejtorisë së Arsimit ne Istog me dt.08.05.2018, vërtetohet së i njëjti ti jetë drejtuar me kërkesë për kompensim të tre pagave përcjellës dhe tre jubilarë.

Nga njoftimi i Drejtorisë për Arsim në Istog me nr. 05.Nr. 198/18, 10.05.2018 vërtetohet se e paditura i ka kthyer përgjigje paditësit sa i përket kërkesës për kompensim.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadiisë gjykata e ka vërtetuar të njëjtën mbi bazën e listës së pagave respektivisht të qarkullimit bankar të paditësit dhe kontratës së punës.

Për Gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ishte në marrëdhënie punë në Shkollën SHFMU “.....”, në fshatin, Komuna e, dhe se i ka përfunduar punësimi me datën: 01.08.2016, për shkak të pensionimit e po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se përvoja e sajë punës ishte: 40 vite, ky fakt është vërtetuar me vërtetimin mbi përvojën e punës: numër 2585/2016, të datës: 01.12.2016 të lëshuar nga SHFMU- “.....”, në fshatin, Komuna e, dhe vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ‘.....’, nr. 660 i dt.02.12.2016,

si dhe paga e ti e fundit neto para pensionimit tek e paditura ishte: 452.20 euro, në muaj, kjo gjendje faktike gjen mbështetje në Lajmërimin për Përfundimin e Shërbimit pensionimin me numër: 05 Nr.1167/16 i datës, 01.08.2016, si dhe provat tjera, të cilat prova janë prezantuar nga i autorizuari i paditësit.

Baza juridike e kërkesëpadisë: gjen mbështetjen në nenin: 4 par. 2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditëses parashihet se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se *“1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4. kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeq”*. Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*.

Po ashtu në nenin 52 par. 1.3 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data: 01.01.2015, ndërsa paditësja ka dal në pension me datën: 01.08.2016, çka do të thotë se kjo Marrëveshje – Kontratë ka qenë në fuqi në momentin e pensionimit dhe se të njëjtat janë pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës, nga rrjedhe edhe themelësia e kërkesëpadisë, parashihet se punëtorit i takon shpërblimi jubilar *“për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”*, ndërsa neni 53 thotë: *“I punësuarit, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit”*.

Po ashtu Gjykata thekson se sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë e njëjta gjen mbështetje edhe në dispozitat e nenin: 2 par.1.1 dhe par.2.para.21.2, nenit 35.8 dhe 35.9, të Kontratës Kolektive, e nënshkruar në mes të MASHT/it dhe SBASHKU/ut, e cila ka hyrë në fuqi me datën: 18.04.2017, me ditën e nënshkrimit, edhe me këtë Kontratë përcaktohet se punëtorët që dalin në pension përfitojnë 3(tri) paga përcjellës dhe shpërblim jubilar, dhe dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendrës së kompetencës dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës të cilat janë anëtare të SBASHK-ut, dhe nenit 2 paragrafi 1 pika 2, përcaktohet se *“dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etje, në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*, për çka edhe gjykata e aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Në nenin 35 par 8 të Kontratës Kolektive punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, për 40 vjet

të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, dhe shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, dhe nenin 35 par 9 të kësaj kontrate (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, çka do të thotë se paditësi-i punësuar këtë të drejtë për përfitim të shpërblimit jubilar e ka pasur në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, sepse kjo kontratë bënë parashikimin e këtij lloji shpërblimi, e përderisa paditësja ka pasur përvojën e punës dhe atë 40 vite, përvojë pune, ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë të paraqitjes së kërkesëpadisë.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”, ndërsa në dispozitat e nenit 245 parag.1 të LDM-së, ka paraparë se “Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, andaj meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se e paditura e ka obligim që t’ia kompensojë 3 (tri) paga jubilarë dhe 3 (tri) paga për përcjellje në pension ashtu siç është përcaktuar me lartë.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata e ka vërtetuar të njëjtën mbi bazën e listës së pagave respektivisht të qarkullimit bankar të paditëses dhe kontratës së punës.

Edhe sa i përket pretendimit për të pezullimin e procedurës të parashtruar nga përfaqësuesi i të paditurës me anë të përgjigjes në padi, gjykata në një propozim të tillë nuk e ka miratuar, për arsye se për pezullimin e procedurës sepse dispozita e nenit: 68 par.1, të Ligjit nr. 03/L-048 Ligj për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive me të cilin është ndryshuar, riformuluar neni: 67 dhe 68 të Ligjit të njëjtë bazik, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka pasur raste të pazgjidhura në gjykata që bazohen në një ankese ose kërkesë të përshkruar me paragrafin 1 të nenit 67 të këtij ligji, dhe Ministria e Drejtësisë nuk është pjesëmarrëse në këtë rast: (I) Rasti, për nga pikëpamja juridike, automatikisht pezullohet, dhe pika (II) Cilido autoritet publik ose gjykatë e cila është e përfshirë në rastin e pazgjidhur ose një rast të mëhershëm i cili ndërlihet me këtë çështje, menjëherë duhet ta njoftojë Ministrinë dhe Ministrinë e Drejtësisë mbi rastin dhe duhet tu sigurojë këtyre ministrive një kopje të plote të lëndes. Pezullimi vazhdon deri në skadimin e një afati prej: 180 ditësh i cili fillon në datën kur kopja e lëndes gjyqësore i është dorëzuar të dy Ministrive. Një procedure gjyqësore konsiderohet “e pazgjidhur” nëse nuk ka rezultuar në nxjerrjen e një vendimi të prere (kundër të cilit nuk mund të ushtrohet ankesa), në këtë rast fjala është për lëndet apo rastet e pazgjidhura që gjenden në gjykate në kohën kur ky ligj ka hyrë në fuqi, e që është e datës: 15.07.2010, **dhe në asnjë rast nuk është për çështjet që janë paraqitur pas kësaj date, ndërsa në rastin konkret padia është dorëzuar në gjykate me dt. 26.07.2018.**

Ndërsa lidhur me deklarin e të paditurës se është parashkruar kërkesa për shpërblimin jubilar, gjykata konstaton se një pretendim i tillë është i pa bazuar për faktin se me dispozitën e nenit: 87 të Ligjit të Punës është paraparë se : “ të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Andaj gjykata konstaton se paditësi është pensionuar me datën: 01.08.2016, ndërsa padinë në gjykatë e ka paraqitur me datën: 26.07.2018, brenda afati kohor prej 3 vitesh. Paditësi duke konsideruar se i takon e drejta në kompensimin e 3 (tri), pagave pas pensionimit dhe 3 (tri) paga për shpërblim jubilar, pasi që e paditura nuk e ka bërë pagesën e tyre. Për realizimin e tyre i është drejtuar gjykatës me padi të parashtruar me datën: 26.07.2018.

Gjykata me rastin e vendosje ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe kundërshtimet e dhëna në fjalën përfundimtare të theksuar nëpërmjet të përfaqësuesit të saj mirëpo nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe.

E duke ju referuar dispozitës së nenit: 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjithat faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në lidhje me kamatën ligjore gjykata nuk e aprovoi kërkesën e palës paditëse që kamata ligjore prej 8% të paguhet nga data e paraqitjes së padisë e që është data 26.07.2018, mirëpo vendosi që e paditura duhet ta paguaj kamatën për kompensimin për pagat përcjellëse dhe jubilarë, si në pikën I të dispozitivit, pasi që gjykata ka vlerësuar se kamata rrjedh nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e që në rastin konkret është data 20.04.2021, kjo bazuar në nenin 382 parag.1 dhe 2 të LMD-së, pasi që pala e paditur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi është në dijeni për lartësinë e kompensimit në emër të pagave përcjellëse dhe jubilarë të paditësit dhe e njëjta nga data e lartcekur bie në vonesë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit: 449, 452.1 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditëses t'ia paguajë shumën totale prej: 508 €, në emër të shpenzimeve të procedurës dhe atë për përpilimin e padis shumën prej: 104 euro, për parashtrësën për precizimin e padisë shumë prej 104 euro, për dy seancë gjyqësore shumë prej 270 euro, për secilën nga 135 euro, dhe 30 euro për taksën gjyqësore për padi, sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit: 143 të LPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA NE ISTOG, Departamenti i
Përgjithshëm, C.nr. 240/18 me dt. 20.04.2021.**

**Gjyqtari
Migjen Kastrati**

Udhëzim juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpër mes të kësaj gjykate.